Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Majlinda Bedrolli ***Ekspert shqyrtues***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***09.06.2022***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***15.06.2022***	***Nr. i lëndës:*** ***174/22***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 30.05.2022, OE ankues **"Petrol Company" shpk-Fushe Kosove**, ka parashtruar ankesë me nr: **174/22,** kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: ***"Furnizim emergjent me karburant derivate për automjete" për nevoja të MM FSK-së",*** me nr.të prokurimit**:** 217-22-3871-1-1-5, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Ministria e Mbrojtjes.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontraë, lloji i kontratës furnizim.

Data e njoftimit për kontratë dhe dosja e tenderit 10.05.2022, Hapja e tenderve 11.05.2022 ora 10:00, Njoftimi për dhënie të kontratës 13.05.2022, Njoftimi për nënshkrim të kontratës 17.05.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankus pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, siç janë:

Neni 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim i LPP

Neni 35.2(iii) Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës i LPP

Shkelje e UA nr. UA/2016-18-3702-111

Neni 22(d)i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimin Publik

Neni 132 Prokurimet e Mbyllura në Kundërshtim me këtë ligj

Neni 26 i kushteve të përgjithshme të kontratës

Neni 61 i Rregullave dhe Udhëzuesi Operativ të Prokurimin Publik

Neni 52.7 i Rregullave dhe Udhëzuesi Operativ të Prokurimin Publik

DEKLARATA DETALE E ANKESES

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi i LPP përcakton *"7.1 Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.* **Ndërsa** 7*.4 "Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik".*

Konsiderojmë se Ministria e Mbrojtjes ka shkelur nenin 7 (diskriminimin) e LPP sepse ka diskriminuar kompaninë tone duke mos na ofruar asnjë informata zyrtare dhe ne te njëjtën kohë ka shkelur parimin e transparencës sepse nuk ka qene fare transparente edhe përkundër shume përpjekjeve tona. Arsyetimi bazohet edhe ne vendimin e ministrit me numër të protokollit 980 të datës 26.04.2022 te cilin vendim ne si furnizues - asnjëherë nuk e kemi pranuar.

Neni 35.2.1(iii) Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës i LPP përcakton *"nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivisht të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues."*

Ministria e Mbrojtjes ka shkelur ketë nen sepse nuk ka fare urgjencë ne ketë aktivitet te Prokurimit nisur nga fakti se Ministria ka kontratën ne fuqi për ketë aktivitet te Prokurimit me kompaninë tone.

Neni 95.3 Aktivitetet e Prokurimit të AQP i LPP përcakton "*Në rastin e përmendur në paragrafin e mësipërm, një autoritet kontraktues porosit AQP-në për mallrat, punët ose shërbimet e prokuruar nga AQP-ja siç referohet në paragrafin 2. Për këta artikuj, pune apo shërbime autoriteti kontraktues nuk do të udhëheq ndonjë aktivitet të pavarur të prokurimit. Çdo kontratë e lidhur në shkelje të këtij paragrafi do të deklarohet si e pavlefshme.*"

Qeveria e Kosovës ka autorizuar AQP për udhëheqje te aktivitetit te Prokurimit përmes UAnr.UA/2016-18-3702-111. AQP ka udhëhequr aktivitetin e Prokurimit dhe ne jemi shpërblyer me kontratë me date 02.05.2019. Sipas nenit 1.4 kontrata ishte parapare qe te hynë ne fuqi me datën 12.07.2019 dhe te përfundonte me datën 11.07.2022. Me datën 16.07.2019 është bere amendamentimi i kontratës dhe kushti I cili ka ndryshuar ne bazë te këtij amendamentimi është data e hyrjes ne fuqi te kësaj kontrate. Pra sipas Amendamentimit hynë në fuqi me datën 12.08.2019 dhe te përfundonte me datën 11.08.2022. Gjatë gjithë periudhës se implementimit nuk është paraqitur asnjë ankesë nga asnjë autoritet kontraktues. Kontratat përmbyllet pas 3 muajve. Ndërkoha Ministria e Mbrojtjes ka filluar aktivitetin e ri për furnizim me derivate e kjo është ne kundërshtim me nenin 95.3 sepse sipas këtij nenin furnizimet mund te porositen vetëm nga AQP dhe AK nuk mund të udhëheq aktivitet të ri dhe njëkohësisht shkelje e UA/2016-18-3702-111.

22.d. Njoftim për dhënie të kontratës; *"Nëse një AK ka bërë dhënie të një kontrate publike duke përdorur procedurë të hapur, kufizuar, konkurruese me negociata,* ***negociuar*** *pa publikim ose kuotim të çmimit ose ka administruar një konkurs të projektimit ZP, pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave ne përputhje me nenin 108/A të LPP-se, do të përgatisë Njoftimin e Dhënies së Kontratës/Njoftimin e Rezultateve të Konkursit të Projektimit pavarësisht nga lloji apo vlera e parashikuar"*

Neni 52.9 i RrUOPP përcakton *"Dispozita e Nenit 47.33-47.35 të këtyre rregullave ngjashmërish aplikohen për dhënien, nënshkrimin si dhe shpërndarjen e kontratës së nënshkruar*: Meqenëse nenin 47.32 i RRuopp përcakton *"Pas miratimit të raportit vlerësues nga ZPP, AK do të përgatitë dhe publikoj Formularin B58 Njoftimin mbi vendimin e AK në platformën e prokurimit elektronik"* dhe neni 47.34 përcakton *"Njoftimi për dhënie te kontratës në përputhje me nenin 41 të LPP-së do të përgatitet duke përdorur formularin standard B08 që krijohet nga*

sistemi i prokurimit elektronik.

Njoftimi i përgatitur për dhënie të kontratës duhet të publikohet në përputhje me nenin 22.d të këtyre rregullave" kjo nënkupton që Ministria e Mbrojtës pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK është dashtë të pres periudhën e ankesave prej 5 dite e jo të publikoj Njoftimin mbi dhënie ditën e nesërme. Lidhja e një kontrate pa përfunduar periudha e ankesave është shkelje e nenit 132 të LPP i cili nen përcakton:

132.1 Kontrata publike ose konkursi i projektimit mund të shfuqizohen pjesërisht ose plotësisht nga OSHP ose një gjykatë, nëse të përmendurit konstatojnë se kontrata publike ose konkursi i projektimit:

1.2. ishte përfunduar gjatë periudhës së pritjes sipas neni 26 të këtij ligji apo gjatë periudhës së vënies së ndonjë mase të përkohshme të urdhëruar nga OSHP ose një gjykatë që ndalon përmbylljen e kontratës;

Edhe pse nuk kemi informata zyrtare se është ndërpre kontrata konsiderojmë se ne rast se Ministria e Mbrojtjes ka ndërpre kontratën, Ministria e Mbrojtjes ka bërë shkelje te neneve si më poshtë:

Neni 26 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues –Kushtet e Përgjithshme të kontratës

26.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 7 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

a) Kur Furnizuesi në mënyrë përmbajtjesore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;

b) Furnizuesi dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;

c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me krediturit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res judicata;

g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti

të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;

i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;

j) Të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

k) Shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

Konsiderojmë qe MFS ka shkelur nenin 26 sepse ka ndërpre kontratën pa u plotësuar asnjë kusht i cili përcaktohet ne rastet kur Autoriteti Kontraktues mund te ndërpres kontratën që nga pika a) deri ne piken l) të nenit 26.1. Për me tepër ne Kushtet e Veçanta të kontratës përcaktohet si në vijim:

Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues	**26**	*Autoriteti Kontraktues ne këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore te Prokurimit*	

Do të thotë AQP ka autoritetin te ndërpres kontratën pasi qe edhe është autoritetit i cili ka nënshkruar kontratën. Nuk ka asnjë rast te vetëm kur një pale e trete mund te ndërpres një kontratë te lidhur mes dy palëve tjera.

Neni 61 Ndërpreja e kontratës- Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i prokurimit Publik

Neni 61 i RRuopp përcakton:

61.27 Kur menaxheri i projektit beson se duhet të ndërpritet një kontratë, menaxheri i projektit do të dorëzojë një rekomandim për ndërprerje tek departamenti i Prokurimit.

61.28 Rekomandimi për ndërprerjen e kontratës do të cek:

(a) emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin e referencës të prokurimit;

(b) arsyet për ndërprerje;

(c) veprimet për shmangien e ndërprerjes;

(d) bazat kontraktuale për ndërprerje;

(e) kosto që burojnë nga ndërprerja, nëse ka ndonjë; dhe

(f) ndonjë informatë tjetër relevante.

61.29 Asnjë kontratë nuk do të ndërpritet para marrjes së aprovimit nga Departamenti i Prokurimit dhe ZKA i autoritetit kontraktues. Kontrata ndërpritet kur Vendimi për ndërprerje i ZKA dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit bëhet i plotfuqishëm. Vendimi bëhet i plotëfuqishëm kur nënshkruhet nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit.

61.30 Kur ndërpritet një kontratë, Departamenti i Prokurimit do ta informojë Operatorin Ekonomik të përfshirë rreth arsyeve të ndërprerjes dhe do të merr masa të menjëhershme në përputhje me kushtet e Kontratës.

Konsiderojmë qe Ministria e Mbrojtjes ka shkelur nenin 61 të RRuopp sepse ka ndërpre kontratën pa dhëne bazën kontraktuale për ndërprerje, veprim për shmangien e ndërprerjes dhe pa marr aprovimin nga Departamenti i prokurimit dhe ZKA i AK, qe ne rastin konkret është AKA dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit i AQP-së pasi qe AQP është institucion i cili ka udhëhequr këtë aktivitet te prokurimit dhe ka nënshkruar këtë kontratë.

52. Procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë-Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik

52.7 Kur ekziston vetëm një furnizues në përputhje me nenin 35 të LPP-së si dhe kur nuk ka alternative, atëherë autoriteti kontraktues duhet: (i) luaj rol aktiv në përcaktimin e termave të kontratës, duke iu referuar posaçërisht çmimit, afateve të dorëzimit, sasive, karakteristikave teknike si dhe garancive; (ii) të siguroj se çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se sa çmimi i tregut në fjalë, dhe (iii) me kujdes ta vlerësoj cilësinë e produktit, shërbimeve apo punëve në fjalë.

Konsiderojmë qe Ministria e Mbrojtjes ka shkelur nenin 52.7 të Rruopp pasi qe ka ftuar vetëm një OE ne negociata dhe ka lidhur kontratën me çmimin me të shtrenjte se çmimi i kontraktuar me kompaninë tonë. Ne kemi premiumin 0.09 cent për litër ndërsa Ministria e Mbrojtjes ka lidhur kontratën e re me çmimin për Premium 0.1570 cent për litër. Kjo shifet se çdo gjë është bere me tendenca te caktuara.

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 11.05.2022, është konstatuar si në vijim: AK-Ministria e Mbrojtjes, shpërblen me kontratë operatorin ekonomik "Kastrati" sh.p.k**,** çmimi total i ofertës /Premium-it pas negociatave 82,111.00 euro.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Autoriteti kontraktues Ministria e Mbrojtjes, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit, lloji i kontratës furnizim (kornizë 6 muaj), vlera e madhe, vlera e parashikuar e kontratës 825,000.00 euro. Pretendimet kryesore kanë të bëjnë kundër njoftimit për dhënie të kontratës të datës 11.05.2022 dhe shkëputjes së kontratës ndërmjet AK-së dhe OE ankues. Kundër të njëjtit njoftim parashtruesi i ankesës "Petrol Company" shpk-Fushe Kosove, me datën 16.05.2022, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pran AK-së, me pretendimet e njëjta ankimore si në ankesën e dorëzuar në OSHP. Sipas shkresës të datës 19.05.2022, AK- Ministria e Mbrojtjes, i përgjigjet kërkesës për rishqyrtim në të cilën thuhet: Sipas kërkesës suaj për rishqyrtim te datës 17.05.2022, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim emergjent me karburant/derivate për automjete" për nevoja të MM/FSK-së" nuk do te trajtohet për arsyet në vijim:
Sipas nenit 4 pragrafi 1.26 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, thuhet :

"Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues. Pra kompania juaj nuk është palë e interesit pasi nuk ka interes material nga ky aktivitet i prokurimit pasi nuk keni dorëzuar oferte fare''.
Vlen te theksohet se procedura është zhvilluar ne përputhje me nenin 35 emergjence ekstreme për shkak të rrethanave te krijuara ne AK, pas marrjes se vendimit nga ministri, me numër të protokolli **980 të datës 26.04.2022** dhe në komunikim te vazhdueshme me AQP-në.

<u>Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP)</u>

Fillimisht sqarojmë se duke u bazuar në shkresat e lendes Autoriteti kontraktues Agjencia Qendrore e Prokurimit- AQP, ka lidh kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull "Funizim me karburante (benzin dizell)- Lot V" me numër të prokurimit UA/2016 18-3702-1-1-1, me operatorin ekonomik "Petrol Company" shpk- Fushe Kosove, tani parashtrues i ankesës, për furnizim me karburante për Ministria e Mbrojtjes, dhe kjo kontratë ka hyre ne fuqi me datën 12.08.2019, dhe do të përfundonte me datën 11.08.2022.

Ne bazë të shkresave te lendes, Ministri i Ministrisë së Mbrojtjes me datë 22.04.2022 ka nxjerr vendimin **1/188/2022**, ku ne dispozitivin I të këtij vendimi potencohet: ***"Ndalohet furnizimin me karburante për MM/FSK sipas kontratës "Furnizim me karburante (benzin dizell) – LOT V" me numër prokurimi UA/2016 18-3702-1-1-1 dhe numër të brendshëm AQP 18 002 111"***, kurse në dispozitivin II të këtij vendimi potencohet: ***"Obligohet Zv.Sekretari i Përgjithshëm që përmes Departamentit Prokurimit dhe kontratave me MM në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ne koordinim me AQP të ndërmarr të gjitha veprimet përkatëse në zbatim të këtij Vendimi përfshirë zhvillimin e procedurave tjera sipas legjislacionit në fuqi për funizim me qellim të mbajtjes së operacionalitetit të FSK-së".*** Tutje, në arsyetim të këtij vendimi thuhet:

"Bazuar ne Njoftimin/Raportin e Inspektoratit të Tregut/MINT të datës 14.03.2022, me numër të raportit 139/2022-TI-M; 140/2022-TI-M; 148/2022-TI-M; 149/2022-TI-M; 128/2022-TI-M, Ministria e Mbrojtjes është njoftuar me rezultatet e testeve të karburantit dizell (funizuar nga kontrata si në dispozitivin 1 të këtij vendimi) të cilat kanë rezultuar si JOKONFORME me dispozitat rregullative dhe ligjore në fuçi".

Bazuar në shkresat e lendes dhe kronologjinë e këtij aktivitetit të prokurimit AK Ministria e Mbrojtjes nëpërmjet shkresës zyrtare të datës **26.04.2022,** ju ka drejtuar AQP duke bashkangjitur vendimin nr. **1/188/2022,** të cekur më lartë, ku thuhet se sipas vendimit ndërpritet furnizimi me karburante sipas kontratës në fjale, pas testimeve që janë bërë. Dhe kërkojmë nga ju si AQP të na udhëzoni si të veprojmë tutje:

a) Vazhdimi i furnizimit me karburant për nevojat e MM/FSK me ndonjë OE tjetër që plotëson kushtet, me të cilin ju si AQP keni kontratë të centralizuar, apo

b) Nisja e procedurës nga MM për furnizim emergjent me karburant.

Në këtë e-mail të datës **26.04.2022**, sekretari i AK Ministria e Mbrojtjes kërkon udhëzime sa më shpejt që është e mundur nga AQP që për shkak të operacionalitetit të MM/FSK.

Në përgjigje të kësaj kërkese të Ministrisë së Mbrojtjes, zv. Drejtori i Përgjithshëm i AQP i përgjigjet në të njëjtën ditë (26.04.2022), ku e njofton që AQP është në pamunduësi që të ndihmoj dhe ti përfshijë në ndonjë

kontratë të AQP-së sipas nenit 9.4 të LPP-së, si dhe e udhëzon që zhvillimi i procedurës së prokurimit është në diskrecion të vet autoritetetit të tyre kontraktues.

Në bazë të kësaj rrethane të krijuar në autoritetin kontraktues Ministria e Mbrojtjes për shkak të rezultateve të nxjerra nga MINT se janë **JOKONFORME**, AK Ministria e Mbrojtjes kishte kërkuar që të përfshihet në ndonjë kontratë ekzistuese të AQP-së dhe në pamundësi të përfshirjes në një kontratë të tillë, AK Ministria e Mbrojtjes në bazë të nenit 35.2.1 (iii) ju ka drejtuar KRPP-së me shkresën e datës **29.04.2022**, duke dhënë arsyet e inicimit të këtij aktivitet të prokurimit dhe përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për shkak të nevojave emergjente të furnizimit me derivate për nevoja të FSK-së. Vlen të ceket, se para se të njoftohet KRPP-ja, përmes shkresës së datës **26.04.2022** me numër prot.**14/438** me kod të lëndës KOL ZENELI/G4 me referencë të bashkangjitur nga zv. Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes të datës 26.04.2022 është bashkangjitur dokumenti "Deklarata e Projektit/Kërkesës", ku në këtë dokument jepen arsyet e nevojës emergjente dhe ceket se në rrethanat e krijuara kërkohet furnizim emergjent për shkak se në disa kazerma (në shkresë ceken qytetet) **derivatet janë JO konform rregullativës së lejuar** dhe në disa kazerma tjera **ka sasi të limituar të derivateve.** Ekspertja shqyrtuese vlerëson se në këto rrethana të cilat është gjendur Ministria e Mbrojtjes me mungesë të derivateve, AK e ka arsyetuar përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë sepse në bazë të shkresave të lëndës është dokumentuar nevoja emergjente. Në raste të tilla, LPP ka paraparë përdorimin e procedurave të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë.

Sa i përket pretendimeve të OE "Petrol Company" shpk-Fushe Kosove, se AK Ministria e Mbrojtjes për këtë aktivitet të prokurimit ka shkelur nenin 7 (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi) të LPP-së me arsyetimin se AK ka diskriminuar kompaninë tonë duke mos na ofruar asnjë informatë zyrtare dhe ne te njëjtën kohë ka shkelur parimin e transparencës sepse nuk ka qene fare transparente edhe përkundër shume përpjekjeve tona, ekspertja shqyrtuese sqaron se neni 4 i LPP-së (përkufizimet) te pika 1.35. është përcaktuar:

1.35. Procedura e negociuar - procedura e prokurimit që i lejon autoritetit kontraktues të ftojë dhe të këshillohet me operatorët ekonomik të zgjedhur nga ai për t'i negociuar kushtet e kontratës **me njërin ose më shumë prej tyre.**

Në këtë rast, ekspertja shqyrtuese duke u bazuar në pikën 1.35 të nenit 4 dhe nenit 35 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në nenin 52 të RRUOPP-së, vlerëson se nuk ka pasur diskriminim për shkak se procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë i lejon autoritetit kontraktues që të negocioj me një apo më shumë operator ekonomik. Kurse, AK në bazë të shkresave të lendes në këtë rast sipas procesverbalit të datës **29.04.2022** kishte bërë identifikimin e tetë operatorëve ekonomik të licencuar për tregëtimin e karburanteve në Republikën e

Kosovës, si dhe përzgjedhjen e njërës nga operatorët ekonomik prej tyre me short. Lista e operatorëve ekonomik të identifikuara me licencë ishin:

1. IP
2. EXFIKS
3. OTI GROUP
4. KASTRATI
5. PATRONI
6. AL PETROL (SHELL)
7. AL TRADE
8. HIB

Komisioni në përbërje prej 3 anëtarëve kishte përzgjedhur metodën e shortit prej tre (3) operatorëve ekonomik, nga i pari deri te i treti:

1. Kastrati Group
2. IP
3. OTI GROUP

Në këtë procesverbal ishte shënuar si koment: "vërjejtje: nëse dështon arritja e marrëveshjes me OE e parë të përzgjedhur të vazhdohet sipas renditjes deri tek i treti OE".

OE ankues po ashtu pretendon se AK Ministria e Mbrojtjes është dashur të pres periudhën e ankesave prej 5 ditë e jo të publikoj njoftimin mbi dhënie të kontratës ditën e nesërme dhe lidhja e një kontratë pa përfunduar periudha e ankesave është shkelje e nenit 132 të LPP-së, sqarojmë se neni 26 Nënshkrimi i kontratave publike, par. 4, nën par. 4.1 ka përcaktuar:

4.1.Së paku dhjetë (10) ditë kanë kaluar nga data e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës; ***me kusht që, ky kusht të mos aplikohet për prokurimet urgjente që sipas nenit 35.2.1 (iii).*** *Apo për një aktivitet të prokurimit të bazuar në nenin 36. Apo për kontrata me vlerë minimale;*

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK ka shkelur nenin 35.2.1(iii) të LPP-së, sepse nuk ka fare urgjencë ne ketë aktivitet te Prokurimit nisur nga fakti se Ministria ka kontratën ne fuqi për ketë aktivitet te Prokurimit me kompaninë tone. Sqarojmë se bazuar në shkresat e lendes AK -Ministria e Mbrojtjes, për përdorimin e kësaj procedure e ka njoftuar KRPP me datë 29.04.2022 me shkresë zyrtare, duke dhënë arsyet e inicimit të këtij aktivitet të prokurimit dhe përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit në bazë të nenin 35.1

Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës të LPP-së ku potencohet:

"Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës për të ushtruar aktivitetin e prokurimit vetëm në përputhje me këtë nen. KRPP-ja, në përputhje me nenin 87, paragrafin 2, nën-paragrafin 2.3 të këtij ligji, duhet të njoftohet nga autoriteti kontraktues në fjalë Brenda dy (2) ditëve nga data kur vendimi për përdorimin e procedurave të tilla është marrë. Autoriteti kontraktues duhet që në njoftim të ofrojë një shpjegim të hollësishëm të fakteve të konsideruara dhe justifikim për përdorimin e procedurës". AK në zbatim të kësaj dispozite ligjore e kishte njoftuar KRPP dhe kishte dhënë arsyet e përdorimit të kësaj procedure, ashtu siç janë dhënë sqarimet në mënyrë kronologjike më lartë.

Sa i përket asaj që OE ankues potencon se nuk ka urgjencë dhe ka kontratë ne fuqi për ketë aktivitet të prokurimit, ekspertja shqyrtuese vlerëson se mos marrëveshjet në mes të palëve në lidhje me zbatimin apo mos zbatimin e kushteve të kontratës, kompetencë për këto mosmarrëveshje ka gjykata kompetente.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se Qeveria e Kosovës ka autorizuar AQP për udhëheqje të aktivitetit të Prokurimit përmes UAnr.UA/2016-18-3702-111, ku AQP ka udhëhequr aktivitetin e Prokurimit dhe ne jemi shpërblyer me kontratë me date 02.05.2019. OE ankues në ankesë e cek edhe ndërprerjen e kësaj kontratë se nuk është në dijeni dhe se ndërprerja e kontratës është në kundërshtim me nenin 26 (Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues –Kushtet e Përgjithshme të kontratës), Ekspertja shqyrtuese sqaron se nuk është kompetencë të ekspertit që të zgjidh mos marrëveshjet për ndërprerjen e kontratës apo mosmarrëveshjet që lindin pasi të lidhet kontrata, si dhe siç është sqaruar më lartë kompetente për këto çështje është gjykata.

<u>Provë: bashkangjitur me raport gjeni kopje :</u>

Vendimin e Ministrit të Ministrisë së Mbrojtjes i datës 22.04.2022 me nr. 1/188/2022.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, rrjedhën e kësaj procedure të prokurimit eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues – Ministria e Mbrojtjes

- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - “Petrol Company” shpk-Fushe Kosove